



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.7

2005

10 shkurt

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4476 datë 28.1.2005	Për shpallje ligji.....	307
Vendim i KM nr.51, datë 28.1.2005	Për shpalljen e vitit 2005 “Viti i përkujtimit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”.....	307
Vendim i KM nr.52, datë 28.1.2005	Për shpërndarjen me koeficient kreditorëve të shoqërisë “VEFA HOLDING” sh.p.k., në administrim, të vlerave financiare, të realizuara nga shitja e asetëve.....	307
Vendim i KM nr.53, datë 28.1.2005	Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfituar strehim nga programet e banesave sociale me qira.....	309
Vendim i KM nr.54, datë 28.1.2005	Për përcaktimin e kriterëve për dhënien e lejeve profesionale specialistëve që kryejnë projektimin, vlerësimin, konsulencën, monitorimin dhe drejtimin teknik të veprimtarisë minerare.....	312
Vendim i KM nr.56, datë 28.1.2005	Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave.....	312
Vendim i KM nr.58, datë 28.1.2005	Për financimin e Konferencës Ndërkombëtare të Tokës, që do të zhvillohet në Tiranë, në datat 13-18 mars 2005.....	313

Vendim i KM nr.59, datë 28.1.2005	Për kryerjen e analizave të vlerave të treguesve të tokës bujqësore	314
Vendim i KM nr.60, datë 28.1.2005	Për miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së themelimit të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.....	315
Vendim i KM nr.61, datë 28.1.2005	Për disa shtesa në vendimin nr.90, datë 21.3.2002 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Lezhë-Balldre, pjesë e seksionit Lezhë-Shkodër”	317
Vendim i KM nr.63, datë 28.1.2005	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Beratit.....	320
Vendim i KM nr.64, datë 28.1.2005	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Pogradecit.....	321
Vendim i KM nr.65, datë 28.1.2005	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Sarandës.....	322
Vendim i KM nr.66, datë 28.1.2005	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Gjirokastrës.....	323
Vendim i KM nr.71, datë 4.2.2005	Për rritjen e masës së trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake, dhe të pilotëve fluturues, në pension	324
Vendim i KM nr.73, datë 4.2.2005	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Delvinës së mjediseve të ish-brigadës së këmbëtorisë, në Rusan, Delvinë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”	324
Vendim i KM nr.74, datë 4.2.2005	Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, të një mjedisi të “Alba Film Studio”, Tiranë, shoqërisë “ORAFILM” sh.p.k., Tiranë.....	325
Vendim i KM nr.76, datë 4.2.2005	Për një shtesë të numrit të punonjësve në Misionin e Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit European.....	325
Vendim i KM nr.77, datë 4.2.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.766, datë 8.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike ushtarake të rëndësishme të veçantë”, të ndryshuar.....	327

DEKRET
Nr.4476, datë 28.1.2005

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 84 pika 1 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr.9341, datë 10.1.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.9297, datë 21.10.2004”.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.51, datë 28.1.2005

**PËR SHPALLJEN E VITIT 2005 “VITI I PËRKUJTIMIT TË GJERGJ KASTRIOTIT-
SKËNDERBEUT”**

Në mbështetje të nenit 95 pika 2 dhe nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shpalljen e vitit 2005 “Viti i përkujtimit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut” në kuadër të 600-vjetorit të lindjes së Heroit kombëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.52, datë 28.1.2005

**PËR SHPËRNDARJEN ME KOEFICIENT KREDITORËVE TË SHOQËRISË “VEFA
HOLDING” SHPK, NË ADMINISTRIM, TË VLERAVE FINANCIARE, TË REALIZUARA
NGA SHITJA E ASETETEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërndarjen kreditorëve të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, të vlerave financiare, sipas koeficientit të kthimit të shumave, në masën 11 për qind, të llogaritur si raport i të

ardhurave, të realizuara dhe të depozituara në bankë, nga shitja e aseteve dhe shumës së detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse ka ndaj kreditorëve, ku:

a) të ardhurat financiare, të realizuara nga shitja e aseteve të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, dhe të depozituara në bankë janë 3 800 000 000 (tre miliardë e tetëqind milionë) lekë;

b) shuma e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve, është 34 361 781 170 (tridhjetë e katër miliardë e treqind e gjashtëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë.

2. Shpërndarja e vlerave financiare për rrethet Tiranë, Vlorë, Durrës dhe Korçë të kryhet nga Banka Kombëtare Tregtare.

Rregullat për mënyrën, kohën dhe radhën e shlyerjes së kreditorëve do të caktohen në një marrëveshje të veçantë, ndërmjet Grupit Mbikëqyrës dhe Bankës Kombëtare Tregtare.

3. Të ardhurat financiare, që do të sigurohen nga shitja e aseteve të mbetura gjendje, sipas pasqyrës që i bashkëlidhet këtij vendimi, pas fillimit të kompensimit të kreditorëve, të depozitohen në llogaritë që do të çelen pranë Bankës Kombëtare Tregtare për llogari të kreditorëve të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim dhe të përdoren në dobi të tyre, sipas kriterëve, rregullave dhe procedurave, që do të caktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

4. Vlera financiare prej 3 800 000 000 (tre miliardë e tetëqind milionë) lekësh (e konvertuar), gjendje në llogaritë bankare të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, në Raiffeisen Bank, të transferohet, brenda muajit janar 2005, në llogarinë për shlyerjen e kreditorëve, të çelur pranë Bankës Kombëtare Tregtare.

5. Shpenzimet për komisionin e shërbimit bankar, që do të kryhet pranë sporteleve të Bankës Kombëtare Tregtare, në zbatim të pikës 2 të këtij vendimi, në shumën 100 (njëqind) lekë për çdo kreditor, e cila në total arrin vlerën 7 400 000 (shtatë milionë e katërqind mijë) lekë, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Kjo shumë të shtohet në planin financiar të Grupit Mbikëqyrës, zëri “Shpenzime”, në përfundim të shlyerjes së vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Vefa Holding”, sh.p.k., në administrim.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e pavarur të shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

**LISTA E ASETEVE TË MBETURA DHE TË PASHITURA TË SHOQËRISË HUAMARRËSE
“VEFA HOLDING” SHPK, NË ADMINISTRIM**

	Asete në administrim	Vendndodhja e objektit	Indeks	Numri i dokumentit hipotekor	Sipërfaqja e objektit	
					Gjithsej m ²	Ndërtime m ²
a	b	1	2	3	4	5
1.	Shoqëria “Vefa					

	Holding” sh.p.k., në administrim					
1.1	Ndërtesë dykatëshe	Tiranë	v.006	473	460	220
1.2	Truall në fshatin Qafë	Skrapar	v.160	45	290	-
1.3	Ndërtesë e ish-fabrikës së lëkurës	Skrapar	v.156	179	1000	457
1.4	Ish-hotel Gjerbës	Skrapar	v.159	54	232	170
1.5	Objekt në Zavalinë	Elbasan	v.116	171	475	470
1.6	Magazinë e prodhimit të sallamit	Përmet	v.082	1553	542	460
1.7	Tokë bujqësore	Pukë	v.129	1410	4000	-
1.8	Depo drithi	Skrapar	v.157	58	1000	1000
1.9	Baxho “Dobrush”	Skrapar	v.161	8	112	160
1.10	Ish-pularia	Shkodër	v.133	9354	48800	10700
1.11	Lokal në Babli	Mat	v.127	5	210	210
1.12	Baxho qumështi Pobrat	Berat	v.166	177	900	300
1.13	Magazinë	Përmet	v.84	1030	183	174

VENDIM
Nr.53, datë 28.1.2005

**PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM, AFATEVE DHE
PROCEDURAVE PËR TË PËRFITUAR STREHIM NGA PROGRAMET E BANESAVE
SOCIALE ME QIRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Familja që plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 4 e 5 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, ka të drejtë të paraqesë kërkesën për strehim në bashki, në zyrat e strehimit, kur është:

- a) banor i njësisë vendore, ku ai paraqet kërkesën;
- b) banor i një njësie tjetër vendore, por që vërteton se është i punësuar në njësinë vendore ku ai paraqet kërkesën.

2. Familja paraqet kërkesën për t’u trajtuar me strehim në çdo kohë, sipas formularit tip, të miratuar nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- a) Identitetin e kërkuarit;
- b) Përbërjen familjare;
- c) Gjendjen me strehim;
- c) Të ardhurat neto të familjes;
- d) Formën e trajtimit sipas njërës nga programet sociale të strehimit;
- dh) Kërkesat e veçanta për statusin e njërës prej anëtarëve të familjes;
- e) Deklaratën e vërtetësisë së informacionit paraprak, të dhënë prej tij.

3. Zyrat e strehimit në bashki të bëjnë seleksionimin e formularëve të vlefshëm dhe t’ia

kalojnë për shqyrtim komisionit të strehimit, të ngritur me vendim të këshillit bashkiak.

4. Përbërja dhe funksionimi i komisionit të strehimit përcaktohen në bazë të rregullores së miratuar nga kryetari i bashkisë.

Në përbërje të këtij komisioni bëjnë pjesë, me të drejtat e plota të anëtarit, edhe përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse, të regjistruara në përputhje me aktet ligjore në fuqi, të cilat mbrojnë interesat e grupeve të ndryshme sociale, të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004.

5. Familjet të cilat kanë përfituar statusin e të pastrehut, sipas akteve ligjore në fuqi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, e që nuk janë trajtuar me strehim, duhet të paraqesin dokumentacionin, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

6. Komisioni i strehimit, brenda një afati kohor prej 6-muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin e dorëzuar dhe të vendosë pikët, sipas sistemit të pikëzimit, të miratuar nga këshilli bashkiak.

7. Komisioni i strehimit, bazuar në:

a) numrin e banesave sociale të ndërtuara;

b) numrin e banesave, që do të blihen në treg;

c) numrin e banesave në treg, për të cilat enti menaxhues ka marrëveshje paraprake me pronarin për t'i përdorur për përfitimin e bonusit të strehimit;

ç) të ardhurat neto të familjes dhe aftësinë përballuese, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 6 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 dhe në lidhjet "A" e "B", bashkëlidhur ligjit,

përzgjedh ndër familjet, që kanë grumbulluar pikët maksimale, ato që do të trajtohen, brenda vitit, me banesë sociale me qira dhe harton listën paraprake të familjeve përfituese.

8. Zyrat e strehimit në bashki, brenda 10 ditëve nga data e seleksionimit të përfituesve, njoftojnë familjet, që përfitojnë banesë sociale me qira, si dhe ato që nuk kanë përfituar.

9. Familjet që nuk kanë përfituar brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, kanë të drejtën e ankimit pranë organeve të qeverisjes vendore.

10. Familjet mund ta refuzojnë banesën dhe të mbeten përsëri në listën e pritjes, vetëm kur nuk u janë plotësuar kushtet e strehimit, sipas normave në fuqi. Në rast të kundërt, u hiqet e drejta për aplikim.

11. Familjet përfituese vazhdojnë aplikimin, duke dorëzuar në zyrat e strehimit, në bashki, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Certifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare;

b) Vërtetimin për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;

c) Vërtetimin e të ardhurave neto të familjes;

ç) Dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;

d) Dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, kur njëri nga anëtarët e familjes është i vetëpunësuar;

dh) Vërtetimin nga zyra e ndihmës dhe përkujdesit pranë bashkive, për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;

e) Vërtetimin nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse, për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;

ë) Vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore, për personat në pension;

f) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e tillë;

g) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit;

gj) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës, se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;

h) Dokumentin zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja;

i) Vendimin e gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara;

j) Vërtetimin përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga

institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;

k) Vendimin e komisionit mjekësor të përcaktimit të verbërisë ose të komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë për punë, për individë me aftësi të kufizuara, që trajtohen sipas shkronjës “d” të nenit 5 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

12. Zyra e strehimit në bashki bën verifikimin e dokumentacionit dhe të informacionit për të ardhurat e familjes, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit. Nëse vërtetohet se deklarimi, dhënia e informacionit dhe faktet janë të rreme, familjes i hiqet e drejta për t’u trajtuar me banesë sociale me qira.

13. Lista me emrat e familjeve përfituese, pas verifikimit të dokumentacionit dhe plotësimit të afatit të përcaktuar në këtë vendim për ankimim, miratohet në këshillin bashkiak dhe bëhet publike.

14. Organet e qeverisjes vendore janë të detyruara të bëjnë publike çdo vit, nëpërmjet mjeteve të informimit publik dhe afishimit në vende të dukshme, pranë institucionit të tyre, këto të dhëna:

a) kërkesat që duhen plotësuar për t’u trajtuar me strehim dhe sistemin e pikëzimit, të miratuara nga këshilli bashkiak;

b) vendndodhjen e banesave, të ndërtuara apo të blera në treg, që do të përdoren si banesë sociale me qira dhe vendndodhjen e banesave, që mund të shfrytëzohen për bonusin e strehimit;

c) personin përgjegjës me të cilin duhet kontaktuar për plotësimin a ndryshimin e të dhënave të formularit apo për çdo sqarim tjetër për plotësimin e tij.

15. Zyrat e strehimit në bashki hartojnë, administrojnë dhe përditësojnë regjistrin e familjeve në listat pritëse.

16. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen edhe në rastet e programeve sociale të strehimit, të parashikuara në pikat 2 e 3 të nenit 3 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004.

17. Ngarkohen organet e qeverisjes vendore të vënë në dijeni, çdo 6 muaj, Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

18. Ngarkohen organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM **Nr.54, datë 28.1.2005**

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E LEJEVE PROFESIONALE SPECIALISTËVE QË KRYEJNË PROJEKTIMIN, VLERËSIMIN, KONSULENCËN, MONITORIMIN DHE DREJTIMIN TEKNIK TË VEPRIMTARISË MINERARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Leja profesionale për veprimtari minerare, në tërësi, për projektimin, vlerësimin, konsulencën e monitorimin, t’u jepet specialistëve, të cilët plotësojnë këto kushte:

a) Të jenë diplomuar në degët që lidhen me këtë veprimtari;

b) Të kenë vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet;

c) Të jenë autorë ose bashkautorë në tri projekte të miratuara e të zbatuara.

2. Leja profesionale të jepet nga një komision i posaçëm, i cili ngrihet me urdhër të ministrit, që mbulon industrinë minerare. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të këtij komisioni përcaktohen me rregulloren përkatëse të miratuar nga ministri, që mbulon industrinë minerare.

3. Specialistët që plotësojnë kriterin e përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij vendimi, por nuk përmbushin kërkesat e tjera, mund të pajisen me leje profesionale vetëm për drejtimin teknik të shoqërive, që ushtrojnë veprimtari minerare.

4. Leja profesionale është personale, përtërihet në çdo pesë vjet dhe regjistrohet në regjistrin themeltar të lejeve profesionale.

5. Ngarkohet Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.56, datë 28.1.2005

PËR PËRCAKTIMIN E MARZHEVE TË FABRIKIMIT DHE TË TREGTIMIT TË BARNAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes së barnave nga fabrikuesit vendas caktohet duke llogaritur një marzh deri në 20 për qind mbi koston e prodhimit.

2. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me shumicë të barnave të importuara nga importuesit dhe shpërndarësit farmaceutikë caktohet duke llogaritur një marzh deri në 18 për qind mbi çmimin CIF, në lekë, të konvertuar sipas kursit mesatar, të njoftuar nga Banka e Shqipërisë, për çdo 6-mujor. Për barnat e prodhuara në vend ky kufi llogaritet mbi çmimin EXW. Marzhi 18 për qind të ndahet ndërmjet importuesit dhe shpërndarësit, përkatësisht, 12.5 për qind dhe 5.5 për qind.

3. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me pakicë të barnave është 33 për qind mbi çmimin e blerjes nga shpërndarësi farmaceutik.

4. Për disa barna të listës që, me vendim të Këshillit të Ministrave, rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të zbatohen marzhe të diferencuara, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave.

5. Pikat 1, 2 e 3 të vendimit nr.182, datë 25.4.1995 të Këshillit të Ministrave “Për çmimet e shitjes së barnave”, të ndryshuar, shfuqizohen.

6. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.58, datë 28.1.2005

PËR FINANCIMIN E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE TË TOKËS, QË DO TË ZHVILLOHET NË TIRANË, NË DATAT 13-18 MARS 2005

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 24 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për

hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin me një fond prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, të Konferencës Ndërkombëtare të Tokës, që do të zhvillohet në Tiranë, në datat 13-18 mars 2005.

2. Ky fond të përballohet si më poshtë vijon:

a) 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit;

b) 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Mjedisit.

3. Fondet e mësipërme të xhirohen në një bankë të nivelit të dytë, në një llogari të veçantë të Institutit të Studimit të Tokave, për Konferencën Ndërkombëtare të Tokës.

4. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.59, datë 28.1.2005

**PËR KRYERJEN E ANALIZAVE TË VLERAVE TË TREGUESVE TË TOKËS
BUJQËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 22 të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Analiza të detyrueshme, të zakonshme të tokës bujqësore.

1. Analiza të detyrueshme, të zakonshme janë:

Analizat që kryhen në mënyrë periodike, me afate kohore të përcaktuara nëpërmjet të cilave pronarët dhe poseduesit e ligjshëm të tokës bujqësore marrin të dhëna të sakta për gjendjen dhe nivelin e pjellorisë së tokës bujqësore, në bazë të së cilave zbatojnë masa të përshtatshme agro-teknologjike për rritjen e rendimentit nga bimët bujqësore të kultivuara.

2. Për pjesën e ngurtë të tokës bujqësore analizohen këta tregues:

a) Për kategorinë e tokave me pjellori normale, analizohen: pH; humusi; NPK; karbonatet; raporti Ca/Mg; Cl; mbetja e thatë; treguesit fizikë, si struktura e tokës dhe përbërja mekanike e saj;

b) Për kategorinë e tokave me pjellori të kufizuar, veç treguesve të përcaktuar në shkronjën

“a” të pikës 2 të këtij kreu, analizohen edhe:

i) për tokat e kripura: pH (H₂O, KCl); mbetja e thatë; Na; Cl;

ii) për tokat acide: pH (H₂O, KCl); aciditeti hidrolitik;

iii) për tokat magneziale: raporti Ca/Mg;

c) Për kategorinë e tokave torfike, tregues të veçantë që analizohen janë: pH; humusi; konduktiviteti elektrik.

3. Analizat e vlerave të treguesve të tokës, për pjesën e ngurtë të saj, kryhen çdo 5 vjet.

4. Organizimi i marrjes së mostrave për analizat e zakonshme të tokës bujqësore bëhet nga seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në këshillin e qarkut.

5. Shpenzimet e analizave të detyrueshme, të zakonshme, të tokës bujqësore mbulohen nga pronari ose poseduesi i ligjshëm i tokës bujqësore, sipas tarifave, që miratohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Detyrimi për kryerjen e analizave për gjendjen e ujërave të ujitjes dhe atyre nëntokësore, përcaktohet në bazë të studimit dhe rekomandimeve të Institutit të Studimit të Tokave (IST), në të cilat përcaktohen zonat bujqësore dhe burimet e ujit, që i nënshtrohen analizës.

7. Treguesit e gjendjes së ujërave të ujitjes dhe atyre nëntokësore, që analizohen janë: pH; konduktiviteti elektrik; Na; K; Ca; Mg; karbonatet dhe bikarbonatet; Cl; sulfatet dhe fosfatet; azoti nitrik dhe amoniakal; mbetja e thatë; SAR, si dhe elementet ndotëse të metaleve të rënda si: Cu; Cd; Mn; Zn; Fe; Co; Ni; Cr; V; B; Pb.

8. Organizimi i marrjes së mostrave për analizë dhe mbulimi i shpenzimeve për analizat e treguesve të ujit për ujitje bëhen nga shoqatat e përdoruesve të ujit, që veprojnë në territorin ku përdoren burimet e ujit për ujitje.

II. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Mjedisit dhe strukturat e tjera shtetërore, të ngarkuara për mbrojtjen e tokës bujqësore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.60, datë 28.1.2005

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË THEMELIMIT TË BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit të nenit 1 të marrëveshjes së themelimit të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim si më poshtë vijon:

“Neni 1

Qëllimi

Për të kontribuar në rindërtimin dhe progresin ekonomik, qëllimi i Bankës do të jetë nxitja e drejtimit drejt ekonomisë së orientuar nga tregu dhe promovimi i nismave dhe sipërmarrjeve private në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore, të angazhuara për të zbatuar parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmin dhe ekonominë e tregut. Banka ka si qëllim të zbatojë të njëjtat parime edhe në Mongoli. Sipas çdo reference të kësaj marrëveshjeje dhe anekseve të saj për “Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore”, “Vendet nga Europa Qendrore e Lindore”, “Vendi përfitues (apo

vendet)” a “vendi anëtar përfitues (ose vendet)”, do t’i referohen, gjithashtu, edhe Mongolisë.”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKSI A

DEKLARATA E PRANIMIT

(Drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Bankës)

Kam nderin t’ju informoj që vendi anëtar Shqipëria pranon amendamentin e propozuar të ligjit të marrëveshjes së themelimit të Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH-it).

(Një kopje e statusit, dekretit, rregullave, sipas të cilave pranohen vendet, është dhënë bashkëlidhur.)

ANEKSI B

NJOFTIMI I PRANIMIT

(Drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Bankës)

Kam nderin t’ju informoj që vendi anëtar Shqipëria ka pranuar amendamentin e propozuar të ligjit të marrëveshjes së themelimit të Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH-it).

(Një kopje e tekstit të pranimi dhe statusi, dekreti, rregullat, sipas të cilave pranohen vendet, janë bashkëlidhur.)

Përmbledhje shpjegimesh

Në përputhje me marrëveshjen e themelimit të BERZH-it të nënshkruar në vitin 1990, BERZH-i ka mandatin për të vepruar në “Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore” të angazhuara për të zbatuar parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmin dhe ekonominë e tregut. Në vitet 1990, shprehja “Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore” kuptonte mbulimin e territorit të republikave ish-socialiste ose republikave socialiste ekzistuese në Europën Qendrore dhe Lindore, duke përfshirë dhe të gjithë Bashkimin Sovjetik.

Si rezultat i shpërbërjes së tre shteteve (ish-Bashkimit Sovjetik) në fillim të viteve 1990, numri i vendeve pjesëmarrëse në BERZH është rritur nga 8 vende në vitin 1991, në 27 vende në ditët e sotme, ndërsa territori i rajoneve që vepron Banka ka mbetur i njëjtë. Nga ky interpretim që konsiston në qëllimin e themeluesve të BERZH-it, shprehja “Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore” sot mbulon vendet e mëposhtme:

Shqipëri	Maqedoni	Rumani
Armeni	Gjeorgji	Federata ruse
Azerbajxhan	Hungari	Serbi dhe Mali i Zi
Bjellorusi	Kazakistan	Republika sllovake
Bosnje dhe Hercegovina	Republika e Kyrgystanit	Sllovani
Bullgari	Letuani	Taxhikistan
Kroaci	Lituani	Turkmenistan
Republika çeke	Moldavia	Ukrainë
Estoni	Poloni	Uzbekistan

Megjithëse Mongolia nuk bën pjesë në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore dhe nuk është gjithashtu vend pjesëmarrës në Bankë, nuk mund të jetë e ligjshme për Bankën të financojë pa pranuar amendamentin e marrëveshjes së themelimit të Bankës. Qëllimi dhe efekti i amendamentit të propozuar është pranimi ligjrisht i Mongolisë.

SHTOJCA 1

AMENDAMENTI I MARRËVESHJES SË THEMELIMIT TË BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM E ZHVILLIM (BERZH)

Neni 1 i marrëveshjes do të ndryshohet si më poshtë:
(teksti i ri me të pjerrëta)

Neni 1 **Qëllimi**

Për të kontribuar në rindërtimin dhe progresin ekonomik, qëllimi i Bankës do të jetë për të nxitur drejtimin drejt ekonomisë së orientuar nga tregu dhe për të promovuar iniciativat private dhe të sipërmarrjeve private në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore, të angazhuara për të zbatuar parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmin dhe ekonominë e tregut. *Qëllimi i Bankës është të zbatojë të njëjtat parime edhe në Mongoli. Sipas çdo reference të kësaj marrëveshjeje dhe anekseve të saj për “Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore”, “ Vendet nga Europa Qendrore dhe Lindore”, Vendi përfitues (apo vendet “ose”vendi anëtar përfitues (ose vendet,)” do t’i referohen gjithashtu dhe Mongolisë.*

SHTOJCA 2

GUIDË PËR PROCESIN E PRANIMIT TË AMENDAMENTIT

Si një amendament i rëndësishëm për të pranuar Mongolinë si një vend i operacionit të qëllimit dhe funksioneve të Bankës, është e rëndësishme që ky amendament të pranohet nga të gjitha vendet dhe institucionet anëtare. Kjo është në përputhje me dispozitën e nenit 56.1 të marrëveshjes së themelimit të Bankës. Meqenëse amendamenti i propozuar konsiston në modifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, është e këshillueshme të punohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme si vijon më poshtë.

Kur pranohet një amendament ju lutem sigurohuni për realizimin e kushteve të mëposhtme:

E para, ndërmarrja e hapave të tilla ligjore siç mund të kërkojnë nga ligji kushtetues për të pranuar amendamentin.

E dyta, komunikimi me Bankën siç tregohet më poshtë:

- Në qoftë se pranimi është nënshkruar nga dikush me autoritet të plotë për të trajtuar marrëdhëniet e traktatit (p.sh. Kryetari i Shtetit, Kryetari i Qeverisë ose Ministri i Punëve të Jashtme), Banka nuk do të kërkojë vërtetim prove të autoritetit aktual pas pranimi.

- Në qoftë se pranimi është nënshkruar nga një person pa autoritet të plotë (p.sh. Ministri i Financave, Guvernatori i Bankës Qendrore), Banka vetëm e regjistron pranimin, nëse ajo është në një dokument zyrtar të natyrës “me fuqi të plotë” për pranim. Shembujt të vërtetimit të dokumentacionit të pranimi përfshijnë: a) një memorandum ligji nga një zyrë kompetente ligjore (p.sh. Noteri i përgjithshëm apo Ministri i Drejtësisë) që vërteton që pranimi është kryer sipas ligjeve të vendeve anëtare; ose b) një kopje e ligjit vendas që tregon pranimin e amendamentit dhe/ose që autorizon zyrtarisht komunikimin (ose pranimin) e amendamentit.

Nëse personi i cili komunikon pranimin ka autoritet të pranojë edhe amendamentin, komunikimi me Bankën mund të jetë i formës së deklaratës së pranimi në emër të vendit anëtar sipas modelit bashkëlidhur (aneksi A). Për ndryshe, pranimi i dhënë nga person ose trupi kompetent në emër të vendit anëtar mund t’i notifikohet Bankës nëpërmjet një dokumenti të përcaktuar, për të cilën një formë draft e notifikimit të pranimi është bashkëlidhur (aneksi B).

Që amendamenti të hyjë në fuqi kërkohet pranimi nga të gjithë anëtarët e Bankës. Amendamenti do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës të komunikimit zyrtar me Bankën që ka marrë pranimin e të gjithë anëtarëve. Çdo ndryshim i rëndësishëm në statusin apo rregulloren e brendshme, kërkon të bëhet efektiv tre muaj më pas nga data e komunikimit zyrtar nga Banka.

VENDIM
Nr.61, datë 28.1.2005

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.90, DATË 21.3.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEZHË-
BALLDRE, PJESË E SEKSIONIT LEZHË-SHKODËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.90, datë 21.3.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 3 të shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Pronarët e pasurive të paluajtshme shtesë, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 3453 m² tokë arë, për një objekt, me vlerë 6 896 515 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, dru frutorë me vlerë 250 500 (dyqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, kultura bujqësore me vlerë 41 436 (dyzet e një mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme prej 10 341 040 (dhjetë milionë e treqind e dyzet e një mijë e dyzet) lekësh.”.

b) Pas pikës 4 të shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Vlera e shpenzimeve procedurale për këtë shtesë shpronësimi është në shumën 294 000 (dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë.”.

c) Pas pikës 5 të shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë shtesë prej 10 635 040 (dhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyzet) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2005, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.”.

2. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 28.2.2005.

3. Pronarët e përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët në kolonën “Shënime” është shkruar “Plotësim dokumentacioni”, të marrin shpërblimin për efekt të shpronësimit pasi të jenë pajisur me dokumentacionin e plotë ligjor, nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Deri në atë çast paratë do të jenë të bllokuara në bankë.

4. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU LEZHË

Lista e pronarëve që shpronësohen (shtesë e projektit) për shkak të ndërtimit të segmentit rrugor Lezhë-Balldre (seksioni i I-rë)

Lloji i pasurisë: Tokë arë, kulturë bujqësore, dru frutorë dhe objekt nr.8

Nr.	Pronar			Nr. Pas.	Tokë arë			Objekt			Kultura Bujq. 12 lekë/m ²	Dru frutorë në lekë	Totali në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri		Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë	Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë				
1	Kole	Mark	Guri	13/61,13/68					preventiv	6896515			6896515	Plotësim dokumentacioni
2	Gjok	Dedë	Nika	349/12	511	913	466543				6132	32000	504675	Plotësim dokumentacioni
3	Zef	Pashko	Nika	350/10	382	913	348766				4584	96000	449350	
4	Zef	Pashko	Nika	349/15	750	913	684750				9000	0	693750	
5	Luk	Pashko	Nika	350/11	662	913	604406				7944	70000	682350	
6	Ndok	Fran	Gjoni	349/12	388	913	354244				4656	38000	396900	
7	Mikel	Ndok	Gjoni	349/11	114	913	104082				1368	14500	119950	
8	Luk	Rrok	Dedgjoni	447/4	646	913	589798				7752	0	597550	
	Shuma				3453		3152589			6896515	41436	250500	10341040	

Shpenzime procedurale lekë 294 000

Vlera totale e shpronësimit lekë 10 635 040

VENDIM
Nr.63, datë 28.1.2005

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujat dhe kullimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Beratit, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:

2.1 Zona e fushës Berat-Ura e Kuçit dhe Hingës (BRK-1, BRK-2, BRK-11), që kullon një sipërfaqe prej 4099 ha-sh, nga të cilat 150 ha me ngritje mekanike;

2.2 Zona e fushës së Kutallisë, Berat (BRK-4), që kullon me ngritje mekanike sipërfaqen prej 1300 ha-sh;

2.3 Zona e fushës së Starovës, Berat (BRK-8), që kullon me rrjedhje të lirë sipërfaqen prej 250 ha-sh;

2.4 Zona e fushës së Uznovës dhe Peshtanit Berat, (BRK-9, BRK-10), që kullon me rrjedhje të lirë sipërfaqen prej 150 ha-sh;

2.5 Zona e fushës së Kozarës, Kuçovë (KVK-1), që kullon me rrjedhje të lirë sipërfaqen prej 1120 ha-sh;

2.6 Zona e fushës Goraj, Perondi, Tapi, Gegë, Kuçovë (KVK-2, KVK-4), që kullon me rrjedhje të lirë sipërfaqen prej 1180 ha-sh;

2.7 Zona e fushës Tapi e Rreth Tapi (KVK-3), që kullon me rrjedhje të lirë sipërfaqen prej 350 ha-sh;

2.8 Pendët mbrojtëse nga përmbytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

2.9 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

b) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) (një) përfaqësues i qarkut;

d) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit;

dh) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.64, datë 28.1.2005

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË
POGRADECIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Pogradecit, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.
 2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:
 - 2.1 Zona e fushës së Starovës, që kullon një sipërfaqe prej 800 ha-sh;
 - 2.2 Zona e fushës së Leshnicës-Stropckës, që kullon sipërfaqen prej 300 ha-sh;
 - 2.3 Zona e fushës së Çërravës, që kullon sipërfaqen prej 200 ha-sh;
 - 2.4 Zona e fushës së Petrushës, që kullon sipërfaqen prej 250 ha-sh;
 - 2.5 Zona e fushave pranë liqenit të Ohrit (Lin-Hudenisht), që kullon sipërfaqen prej 300 ha-sh;
 - 2.6 Pendët mbrojtëse nga përmbytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;
 - 2.7 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.
 3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
 - a) 2 (dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - b) 2 (dy) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - c) 1 (një) përfaqësues i bashkisë;
 - ç) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - d) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.
 4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.
 5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.
 6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.65, datë 28.1.2005

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË SARANDËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Sarandës, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:

2.1 Zona e fushës së Pavlit (SRK-1), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 1332 ha-sh;

2.2 Zona e fushës Konispol-Zare (SRK-7), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 5000 ha-sh;

2.3 Zona e fushës së Vurgut (SRK-2, DLK-1), me sipërfaqe prej 3643 ha-sh, nga e cila 900 ha me ngritje mekanike;

2.4 Zona e fushës së Vagalatit (SRK-3, SRK-4), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 1585 ha-sh;

2.5 Zona e fushës së Gravës (SRK-4), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 348 ha-sh;

26 Zona e fushës së Butrintit (SRK-6), që kullon me ngritje mekanike në sipërfaqen prej 800 ha-sh;

2.7 Zona e fushës së Borshit (SRK-8), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 130 ha-sh;

2.8. Zona e fushës së Volloderit (SRK-9), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 160 ha-sh;

2.9 Zona e fushës së Navaricës (SRK-10), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 250 ha-sh;

2.10 Zona e fushës së Vurgut, Delvinë (DLK-1), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen 2743 ha-sh;

2. 11 Zona e fushës Stjar-Mesopotam (DLK-2), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 200 ha-sh;

2.12 Zona e fushës së Vergo-Kalasë (DLK-3), që kullon me rrjedhje të lirë në sipërfaqen prej 400 ha-sh;

2.13 Pendët mbrojtëse nga përmbytjet e lumenjve, bregdetare dhe të kanaleve të ujërave të larta;

2.14 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

b) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 1 (një) përfaqësues i qarkut;

d) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit;

dh) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen, çdo muaj, me nga 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.66, datë 28.1.2005

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Gjirokastrës, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.
 2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:
 - 2.1 Zona e fushës së Dropullit (GjK-1, GjK), që kullon sipërfaqen prej 5600 ha-sh;
 - 2.2 Zona e fushës së Gjirokastrës, Vlaresë (GjK-2), që kullon sipërfaqen prej 1750 ha-sh;
 - 2.3 Zona e fushës së Lunxhërisë, Odrijës, (GjK-4), që kullon sipërfaqen prej 1000 ha-s;
 - 2.4 Zona e fushës Cepunë-Mashkullorë, Humelicë, Kardhiq (GjK-5, GjK-6, GjK-7), që kullon sipërfaqen prej 1100 ha-sh;
 - 2.5 Zona e fushës së lumit Vjosë (PRK-1), që kullon sipërfaqen prej 2500 ha-sh;
 - 2.6 Zona e fushës së luginës së lumit Dëshnicë-Këlcyrë-Ballaban (PRK-2), që kullon sipërfaqen prej 600 ha-sh;
 - 2.7 Zona e fushës së luginës së Vjosës, Dragot-Kalivac-Krahës (TPK-1), që kullon sipërfaqen prej 1500 ha-sh;
 - 2.8 Pendët mbrojtëse nga përmbytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;
 - 2.9 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.
 3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
 - a) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - b) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - c) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - ç) 1 (një) përfaqësues i qarkut;
 - d) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - dh) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.
 4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen çdo muaj me nga 5000 (pesë mijë) lekë.
 5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.
 6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.71, datë 4.2.2005

PËR RRITJEN E MASËS SË TRAJTIMIT TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE, QË KANË PUNUAR NË DISA NDËRMARRJE TË INDUSTRIËS USHTARAKE, DHE TË PILOTËVE FLUTURUES, NË PENSION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një

trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake, të nenit 5 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për punonjësit, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake, masa e trajtimit të veçantë, e përfutur sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, rritet 8 për qind.

2. Për pilotët fluturues, në pension, masa e trajtimit të veçantë, e përfutur sipas ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, rritet 8 për qind.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Ministri i Financave dhe drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.73, datë 4.2.2005

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË DELVINËS SË MJEDISEVE TË ISH-BRIGADËS SË KËMBËSORISË, NË RUSAN, DELVINË, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRËORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-brigadës së këmbësores, në Rusan, Delvinë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Delvinës, për t’u përdorur për nevoja strehimi për popullsinë e kësaj bashkie.

2. Prona me numër rendor 638, “ish-brigadë këmbësorie”, në Rusan, Delvinë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Delvinës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe bashkia e Delvinës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr.74, datë 4.2.2005

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË NJË MJEDISI TË “ALBA FILM STUDIO”, TIRANË, SHOQËRISË “ORAFILM” SHPK, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 901 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim, pa shpërblim, për 10 vjet, të një mjedisi të “Alba Film Studio”, Tiranë, me sipërfaqe 200 m², në godinën e repartit të zërit, shoqërisë “Orafilm” sh.p.k., Tiranë, për ngritjen dhe funksionimin e shkollës së lartë jopublike “Marubi”, për filmin dhe multimedian.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.76, datë 4.2.2005

PËR NJË SHITESË TË NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MISIIONIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË BASHKIMIT EUROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 2, e 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 29/1 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 7 e 14 të ligjit nr.9339, datë 21.12.200 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personelit të Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Europian, duke ruajtur strukturën që ka, i shtohen deri në 8 (tetë) punonjës për mbështetjen tekniko-sektoriale të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE, në funksion të bashkërendimit të politikave integruese, përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian dhe të bashkërendimit të ndihmës komunitare për këtë proces.

2. Këta punonjës të jenë nëpunës civilë të ministrive të linjës, që mbulojnë fushat e përqendruara në elementet kryesore të *acquis communautaire*, në zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, sipas përcaktimit të aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Punonjësit emërohen në këtë funksion nga Ministri i Punëve të Jashtme, në zbatim të nenit 20 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit përkatës dhe përzgjidhen nga nëpunësit civilë të këtyre ministrive, sipas kritereve të përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Për periudhën e shërbimit në Mision, punonjësit gëzojnë të gjitha të drejtat e diplomatit, në përputhje me ligjin “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, por nuk përfitojnë gradë diplomatike.

5. Përshkrimi i punës, detyrat kryesore të secilit punonjës, duke u bërë pjesë e veprimtarisë së Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë BE-së, dhe mënyrat e bashkërendimit ndërmjet aspektit diplomatik dhe tekniko-sektorial përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Integrimit Europian me ministritë e linjës.

6. Këta punonjës të paguhen në mbështetje të vendimit nr.673, datë 11.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për të drejtat e punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja”, sipas gradës “sekretar i parë”.

7. Efektet financiare të shpenzimeve, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, që për një vit buxhetor, për çdo punonjës, arrijnë deri në vlerën 9 054 400 (nëntë milionë e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë, do të përballohen nga buxhetet vjetore të çdo ministrie të linjës. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe ministritë e linjës për hartimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për rialokimin e fondeve, në përputhje me fillimin e punës nga punonjësit e emëruar.

8. Ngarkohen ministritë e linjës të propozojnë, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nëpunësit që do të punojnë në Mision.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Integrimit Europian, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit të përgatisin e të miratojnë udhëzimet e përmendura në pikën 5 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKSI I

INSTITUCIONI I PËRFAQËSUAR

FUSHAT QË DO TË MBULOHEN

Ministria e Drejtësisë

- Sistemi gjyqësor: reforma e gjyqësorit pavarësia, transparenca, lufta kundër korrupsionit (trajnimin)
- Të drejtat e njeriut
- Lufta kundër korrupsionit
- Bashëpunimi gjyqësor në fushën civile dhe penale
- Lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikeve
- Legjislacioni tregtar
- Trajtimi i të dhënave personale

Ministria e Bujqësisë dhe
e Ushqimit

- Organizimi i tregjeve bujqësore
- Shërbimet veterinarë dhe fitosanitare
- Industria e agropërpunimit

	- Siguria ushqimore - Politikat strukturore - Siguria e konsumatorit - Produktet bujqësore - Zhvillimi rural - Tregu i tokës (lëvizja e lirë e kapitaleve) - Politikat e peshkimit
Ministria e Ekonomisë	- Lëvizja e lirë e mallrave dhe e shërbimeve - Detyrimet në kuadër të OBT-së - Politikat mbi sipërmarrjet e mesme dhe të vogla - Konkurrenca dhe ndihma shtetërore - Legjislacioni tregtar
Ministria e Financave	- Bashkëpunimi doganor - Lufta ndaj drogës, kontrabandës së vlerave kulturore, armëve të zjarrit etj. - Bilanci i pagesave - Procesi i liberalizimit - Tatimi direkt dhe indirekt - Bashkëpunimi administrativ dhe lufta ndaj evazionit tatimor - Kontrolli financiar - Lufta ndaj mashtrimit - Buxheti dhe financat
Ministria e Mjedisit	- Legjislacioni horizontal - Cilësia e ajrit - Menaxhimi i mbetjeve - Cilësia e ujit - Mbrojtja e natyrës - Kontrolli i mbrojtjes industriale - Kimikatet dhe OMGJ-të - Zhurmat nga automjetet dhe makineritë - Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimi - Ndryshimet klimaterike - Mbrojtja civile - Politikat - Bashkëpunimi ndërkombëtar
Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	- Lëvizja e lirë e punëtorëve - Legjislacioni i punës - Sigurimet shoqërore - Siguria dhe shëndeti në punë - Fondi Social European - Punësimi, mbrojtja sociale dhe dialogu social
Ministria e Rendit Publik	- Menaxhimi i kufirit - Politikat e migracionit dhe azilit - Krimi i organizuar dhe korrupsioni - Bashkëpunimi policor - Trafiku i njerëzve dhe i narkotikëve - Pastrimi i Parave - Terrorizmi
Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit	- Transporti tokësor, detar, hekurudhor, ajror dhe i kombinuar - Teknologjia e informacionit - Telekomunikacioni

ANEKS II
KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFAQËSUESIT TË NJËSISË SË VEÇANTË NË
MISIONIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN

Nëpunësi i emëruar duhet:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë;
- Grada master në studime europiane dhe/ose ndërkombëtare përbën avantazh;
- Të ketë minimalisht 5 vjet eksperiencë pune të ngjashme në institucionin që përfaqëson;
- Të ketë aftësi në përgatitje raportesh, analizash, komunikim dhe prezantim;
- Të ketë njohuri shumë të mira në gjuhën angleze;
- Njohja e një gjuhe të dytë të BE përbën avantazh;
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

VENDIM
Nr.77, datë 4.2.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.766, DATË 8.12.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË DISA LINJAVE TEKNOLOGJIKE
USHTARAKE TË RËNDËSISË SË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.766, datë 8.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e dytë të pikës 1, afati “...deri në 31.12.2003” zëvendësohet me “...deri në 31.12.2005”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Pagesën e gatishmërisë e përfitojnë 200 punonjës të kombinatit mekanik, në Poliçan, 11 punonjës të uzinës së lëndëve plasëse, në Elbasan dhe 9 punonjës të uzinës mekanike, në Gramsh.”.

c) Në fund të pikës 4 viti “...2003...” zëvendësohet me “...2005...”.

2. Fondi prej 37 000 000 (tridhjetë e shtatë milionë) lekësh, i nevojshëm për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2005, zëri “Pagesë papunësie” miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 10.2.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë